1.	Mirëmbajtje "Full Risk" e sistemit imazherik CT Skaner	CT Skaner	Philips/ ekuivalent	MX 16/ ekuivalent	Spitali Bashkiak Lushnjë	12 muaj/ 365 ditë

Shërbimet që duhet të ofrohen: ***Mirëmbajtja full risk sipas rekomandimeve të prodhuesve përkatës të pajisjeve mjekësore që janë në përdorim në Spitalin Bashkiak Lushnjë sipas përshkrimit të më poshtëm të shërbimit:***

Specifikimet teknike

Shërbimet që duhet të ofrohen:

Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet periodikisht sipas rekomandimeve të prodhuesit, me qëllim parandalimin e defekteve që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjes.

Mirëmbajtja korrigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, identifikimin e shkaqeve, eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë sipas rekomandimeve të prodhuesit. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin.

Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisjur me autorizimin e prodhuesit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes për pajisjen përkatëse.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontroleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek kontraktuesi.

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e furnizimit të burimit të ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Ofertuesi duhet të lëshojë një deklaratë që merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.

Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit:

Të gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit të mëposhtme janë në ngarkim të të kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës:

- Tubi i rezeve X (blerja dhe instalimi i saj në rast dëmtimi) për pajisjen përkatëse,
- Gjeneratori i rezeve x,
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit, të nevojshme për funksionimin sipas standardeve.
- Pajisja UPS i pajisjeve

-
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimi që mund të lindë nevoja të zëvendësohen kur defektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes.

I kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitetin me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve:

Personeli teknik i të kontraktuarit do të garantojë mbulimin e shërbimit për 52 javë në vit (365 ditë), me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:00 dhe të shtunën 8:00-14:00. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të kontraktuesit.

Operatori ekonomik duhet të bëjë inspektimin e sigurisë së pajisjeve mjekësore të paktën 1 (një) herë në muaj dhe të përpilojë procesverbalin i cili të firmoset nga komisioni i kolaudimit dhe inxhinieri i operatorit ekonomik .

I kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontratë edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të parashikueshme.

I kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.

I kontraktuar duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes në rastet e emergjencave edhe gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve të diela.

Emri i personit të kontaktit të deklarohet në dokumentet e ofertës.

Shpejtësia dhe shpeshtësia e ndërhyrjeve:

I kontraktuari duhet të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje. Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon dhe email.

I kontraktuari do të sigurojë ndërhyrjen brenda 24 orëve për pajisjet e instaluar.

Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe 5 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.

Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën, gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të përfshijë apo përjashtojë nga shërbimet e përmendura, pajisje të caktuara, veprim ndaj të cilit, i kontraktuari nuk ka të drejtë të kundërshtojë. Kjo mund të aplikohet në rastet e nxjerrjes jashtë përdorimit të pajisjeve apo shtimit të pajisjeve të reja për shkak të përfundimit të periudhës së garancisë. Ky ndryshim do të rezultojë në rishikimin e kontratës. Vlera e zvogëluar ose shtuar do të llogaritet bazuar në vlerën ditore të mirëmbajtjes për atë pajisje dhe ditëve të përfshirjes në mirëmbajtje. Vlera ditore do të llogaritet bazuar në vlerën vjetore të mirëmbajtjes së asaj pajisjeje.

Shërbimi i mirëmbajtjes për pajisjen do të jetë 'Full Risk' ku ofruesi i shërbimit merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes parandaluese si dhe korrigjuese për të gjithë defektet që mund të ndodhin përfshirë edhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit.

Mirëmbajta full risk duhet të përfshijë shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese, riparuese dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit. Kjo kontratë duhet të garantojë performancë të punës së pajisjeve,

vazhdimësinë e punës së tyre duke ofruar shërbim pa ndërprerje për pacientët duke mundësuar shfrytëzimin eficient të këtyre pajisjeve.

Pajisjet mjekësore objekt i kësaj procedure, janë pajisje shumë komplekse. Përdorimi i këtyre pajisjeve kërkon staf të kualifikuar e certifikuar nga prodhuesi. Riparimi i këtyre pajisjeve duhet të kryhet vetëm nga specialistë të kualifikuar dhe të trajnuar posaçërisht për secilën nga pajisjet, pranë prodhuesve respektive si dhe të autorizuar prej tyre, për shkak jo vetëm të kompleksitetit por edhe të rrezikshmërisë së lartë që paraqesin për shëndetin e njerëzve.

Duhet marrë gjithmonë masat për zëvendësimin në kohë të saj si dhe pjesëve të këmbimit me qëllim mosndërprerjen e funksionimit të shërbimit.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Drejtoria e Spitalit “I hsan Çabej” Lushnjë.

Afati i kryerjes së shërbimeve: 12 (dymbëdhjetë) muaj ose 365 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 3: “MIRËMBAJTJE “FULL RISK” PËR PAJISJEN CT SKANER PHILIPS/ MX 16 OSE EKVIVALENT” PËR DREJTORINË E SPITALIT “I’ HSAN ÇABEJ” LUSHNJË”.

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	Mirëmbajtje “Full Risk” e sistemit imazherik CT Skaner	CT Skaner	Philips/ ekuivalent	MX 16/ ekuivalent	Spitali Bashkiak Lushnjë	12 muaj/ 365 ditë

Shënim: *Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.*

Afatet e ekzekutimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj ose 365 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shëbimeve: Loti 3: “Mirëmbajtje “Full Risk” për pajisjen CT Skaner Philips/MX 16 ose ekuivalent” për Drejtorinë e Spitalit “I’ hsan Çabej” Lushnjë”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike.

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike.

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: “Spitali bashkiak Lushnjë”.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 4: “MIRËMBAJTJE FULL RISK PËR AUTOKLAVAT ERYIGIT/ GOLDBERG OSE EKUIVALENT” PËR SPITALIN RAJONAL “MEMORIAL” FIER”.

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësinë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	Mirëmbajtje “Full Risk” pajisjes autoklavë	Autoklavë	Eryigit/ ekuivalent	Goldberg GY 360 O/ ekuivalent s.n: 2021/05-019	Spitali Rajonal Memorial Fier	12 muaj/ 365 ditë

2.	Mirëmbajtje “Full Risk” pajisjes autoklavë	Autoklavë	Eryigit/ ekuivalent	Goldberg GB 120/ ekuivalent s.n: 2021/04-002	Spitali Rajonal Memorial Fier	12 muaj 365 ditë
3.	Mirëmbajtje “Full Risk” pajisjes autoklavë	Autoklavë	Eryigit/ ekuivalent	Goldberg GY 840 D/ ekuivalent s.n: 2021/01-054	Spitali Rajonal Memorial Fier	12 muaj/ 365 ditë

Kompania e cila do të kryejë mirëmbajtjen e aparaturave autoklavë, sic kerkohet “Mirëmbajtje Full Risk” mban përgjegjësi të plotë për çdo defekt ose riparim që do të kryehet në këtë aparat.

Për çdo defekt të cilën ky aparat do të pësojë gjatë periudhës së mirëmbajtjes Full risk, kompania duhet të paraqitet brenda 24 orëve, ditë pune, për konstatimin e defektit ose riparimin e saj.

Në rast nevojë të zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara, është përgjegjësi e kompanisë ti zëvendësojë atë me pjesë origjinale ose mund të ofrojnë pjesë ekuivalente me prodhuesin e pajisjeve që spitali zotëron, me pullë sigurie, të prodhuar për të funksionuar/kompatibël me pajisjet që spitali disponon, por të një marke tjetër prodhuese nga ajo e pajisjeve të cilave do t’u shërbejnë.

Mirëmbajtja dhe kontrolli i gjendjes funksionale i pajisjeve do të jetë i përmuajshëm dhe brenda rregullave të mirëmbajtjes që prodhuesi rekomandon në manualin e mirëmbajtjeve.

Për çdo veprim mbi pajisjen do të mbahet dokumentacion përkatës të dy anshëm.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Spitali Rajonal “Memorial” Fier

Afati i kryerjes së shërbimeve: 12 (dymbëdhjetë) muaj 365 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 4: “MIRËMBAJTJE FULL RISK PËR AUTOKLAVAT ERYIGIT/ GOLDBERG OSE EKVIVALENT” PËR SPITALIN RAJONAL “MEMORIAL” FIER”.

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhuksi	Modeli	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	Mirëmbajtje “Full Risk” pajisjes autoklavë	Autoklavë	Eryigit/ekuivalent	Goldberg GY 360 O/ekuivalent s.n: 2021/05-019	Spitali Rajonal Memorial Fier	12 muaj/ 365 ditë
2.	Mirëmbajtje “Full Risk” pajisjes autoklavë	Autoklavë	Eryigit/ekuivalent	Goldberg GB 120/ekuivalent s.n: 2021/04-002	Spitali Rajonal Memorial Fier	12 muaj/ 365 ditë
3.	Mirëmbajtje “Full Risk” pajisjes autoklavë	Autoklavë	Eryigit/ekuivalent	Goldberg GY 840 D/ekuivalent s.n: 2021/01-054	Spitali Rajonal Memorial Fier	12 muaj/ 365 ditë

Shënim: *Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.*

Afatet e ekzekutimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj ose 365 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Loti 4: “Mirëmbajtje “Full Risk” për Autoklavat Eryigit/ Goldberg ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike.

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike.

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: “Spitali rajonal memorial Fier”.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 5: “MIRËMBAJTJE “FULL RISK” PËR ANGIOGRAFIN BIPLANAR PHILIPS/ AZURION 7 B20/15LN OSE EKUIVALENT” PËR SPITALIN RAJONAL “MEMORIAL” FIER”.

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhuksi	Modeli	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	Mirëmbajtje “Full Risk” e sistemit angiograf biplanar	Angiograf biplanar	Philips/ ekuivalent	Azurion 7 B20/15LN/ ekuivalent	Spitali Rajonal Memorial Fier	12 muaj/ 365 ditë

SPECIFIKIME TEKNIKE

Kompania e cila do të kryejë mirëmbajtjen e aparatit të angiografisë Philips, mban përgjegjësi të plotë për çdo defekt ose riparim që do të kryehet në këtë aparat.

Për çdo defekt të cilën ky aparat do të pësojë gjatë periudhës së mirëmbajtjes 'Full Risk', kompania duhet të paraqitët brenda 24 orëve për konstatimin e defektit ose riparimin e saj.

Në rast nevojë të zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara, është përgjegjësi e kompanisë t'i zëvendësojë atë me pjesë origjinale ose mund të ofrojnë pjesë ekuivalente me prodhuesin e pajisjeve që spitali zotëron, me pullë sigurie, të prodhuar për të funksionuar/kompatibël me pajisjet që spitali disponon, por të një marke tjetër prodhuese nga ajo e pajisjeve të cilave do t'u shërbejnë.

Mirëmbajtja dhe kontrolli i paisjes do të jetë i përmuajshëm dhe brenda rregullave të mirëmbajtjes që prodhuesi rekomandon në manualët e mirëmbajtjeve.

Për çdo veprim mbi paisjen do të mbahet dokumentacion përkatës të dy anshëm.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Spitali Rajonal "Memorial" Fier

Afati i kryerjes së shërbimeve: 12 (dymbëdhjetë) muaj ose 365 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 5: “MIRËMBAJTJE “FULL RISK” PËR ANGIOGRAFIN BIPLANAR PHILIPS/ AZURION 7 B20/15LN OSE EKUVALENT” PËR SPITALIN RAJONAL “MEMORIAL” FIER”.

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	Mirëmbajtje “Full Risk” e sistemit angiograf biplanar	Angiograf biplanar	Philips/ ekuivalent	Azurion 7 B20/15LN/ ekuivalent	Spitali Rajonal Memorial Fier	12 muaj/ 365 ditë

Shënim: *Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.*

Afatet e ekzekutimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj ose 365 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Loti 5: “Mirëmbajtje “Full Risk” për Angiografin Biplanar Philips /Azurion 7 B20/15LN ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike.

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike.

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: “Spitali rajonal memorial Fier”.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 6: “MIRËMBAJTJE “FULL RISK” E PAJISJES MJEKËSORE CT SKANER PHILIPS/ INGENUITY FLEX 32 OSE EKUVALENT” NJËSIA KAVAJË”.

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	Mirëmbajtje “Full Risk” e sistemit CT Skaner	CT Skaner	Philips/ ekuivalent	Philips Ingenuity Flex 32/ ekuivalent	Q.S.R.T Shefqet Ndroqi / Njësia Kavajë	48 muaj/ 1461 ditë

Specifikimet Teknike

Shërbimet që duhet të ofrohen

Mirëmbajtja parandaluese: Ky shërbim ka për qëllim të parandalojë defektet që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin dhe pajisjet në gjendje optimale funksionimi, si dhe për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo perkeqësimi i performancës së pajisjeve.

Mirëmbajtja korrigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, në identifikimin e shkaqeve, në eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, në verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, montimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontrolleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, I kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek kontraktuesi. Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha moskonformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e furnizimit të burimit të ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik çdo fund muaji, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta. Ofertuesi duhet të lëshojë një: Deklaratë që merr përsipërsigurin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.

Pjesët përbërëse të sistemit, pjesë këmbimi, përdorimi dhe konsumit

Të gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit të mëposhtme janë në ngarkim të kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës:

Tubi i rrezeve X (blerja dhe instalimi në rast dëmtimi);

Gjeneratori i rrezeve X,

Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit të nevojshme për funksionim sipas standardeve;

UPS-i i pajisjeve;

Të gjitha pjesët e tjera të këmbimi që mund të lindë nevoja të zëvendësohen kur defektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes.

I kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjatë kryerjes së shërbimeve, me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve:

Personeli teknik i të kontraktuarit do të garantojnë mbulimin e shërbimit për 1461 ditë, me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:00 dhe të shtunën 8:00- 14:00. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të kontraktuesit.

I kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontrate edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të parashikueshme. I kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera. Emri i personit të kontaktit të deklarohet në dokumentet e ofertës.

Shpejtësia e ndërhyrjeve:

I kontraktuari do të duhet të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje.

Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon dhe email.

Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe 5 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.

I kontraktuari duhet të sigurojë që pajisjet të mos qëndrojnë të defektuara për më shumë se 10 ditë zyrtare pune në vit.

Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën, gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të përfshijë apo përjashtojë nga shërbimet e përmendura, pajisje të caktuara, veprim ndaj të cilit, i kontraktuari nuk ka të drejtë të kundërshtojë. Ky ndryshim do të rezultojë në rishikimin e kontratës.

Vlera e shtuar ose zvogëluar do të llogaritet bazuar në vlerën ditore të mirëmbajtjes për atë pajisje dhe ditëve të përfshirjes në mirëmbajtje. Vlera ditore do të llogaritet bazuar në vlerën vjetore të mirëmbajtjes së asaj pajisje.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi” Njësia Kavajë”.

Afati i kryerjes së shërbimeve: 48 (dyzetë e tetë) muaj ose 1461 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 6: “MIRËMBAJTJE “FULL RISK” E PAJISJES MJEKËSORE CT SKANER PHILIPS/INGENUITY FLEX 32 OSE EKUIVALENT” Q.S.R.T “SHEFQET NDROQI” NJËSIA KAVAJË”.

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	Mirëmbajtje “Full Risk” e sistemit CT Skaner	CT Skaner	Philips / ekuivalent	Philips Ingenuity Flex 32/ ekuivalent	Q.S.R.T Shefqet Ndroqi / Njësia Kavajë	48 muaj/ 1461 ditë

Shënim: *Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.*

Afatet e ekzekutimit: 48 (dyzetë e tetë) muaj ose 1461 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Loti 6: “Mirëmbajtje “Full Risk” e pajisjes mjekësore CT Skaner Philips/ Ingenuity Flex 32 **ose ekuivalent**” Njësia Kavajë”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike.

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike.

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: “Q.S.R.T Shefqet Ndroqi / Njësia Kavajë”.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 7: “MIRËMBAJTE “FULL RISK” E PAJISJES MJEKËSORE ANGIOGRAFI SIEMENS/ ARTIS ZEE OSE EKUVALENT” PËR Q.S.R.T “SHEFQET NDROQI”.

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhues i	Modeli	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	Mirëmbajtje “Full Risk” e sistemit angiograf	Angiograf	Siemens / ekuivalent	Artis ZEE/ ekuivalent	Q.S.R.T ”Shefqet Ndroqi”	48 muaj/ 1461 ditë

Specifikimet teknike

Shërbimet që duhet të ofrohen:

Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet periodikisht sipas rekomandimeve të prodhuesit, me qëllim parandalimin e defekteve që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjeve.

Mirëmbajtja korrigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, identifikimin e shkaqeve, eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë sipas rekomandimeve të prodhuesit. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin.

Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me autorizimin e prodhuesit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes për pajisjet përkatëse. Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontrolleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek kontraktuesi.

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e furnizimit të burimit të ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik çdo datë 25 të muajit, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Ofertuesi duhet të lëshojë një deklaratë që merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.

Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit.

Të gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit të mëposhtme janë në ngarkim të të kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës:

- Tubi i rrezeve X (blerja dhe instalimi i saj në rast dëmtimi) për pajisjen përkatëse
- Gjeneratori i rrezeve X,
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit, të nevojshme për funksionimin sipas standardeve.
- Pajisja UPS i pajisjeve
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit që mund të lindë nevoja të zëvendësohen kur defektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes.

I kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve:

Personeli teknik i të kontraktuarit do të garantojë mbulimin e shërbimit për 1461 ditë, me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:00 dhe të shtunën 8:00-14:00. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të kontraktuesit. I kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontratë edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të parashikueshme.

I kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.

I kontraktuar duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes në rastet e emergjencave edhe gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve të diela.

Emri i personit të kontaktit të deklarohet në dokumentet e ofertës.

Shpejtësia dhe shpeshtësia e ndërhyrjeve.

I kontraktuari duhet të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje. Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon dhe email.

I kontraktuari do të sigurojë ndërhyrjen brenda ditës së punës për pajisjet e instaluar në Tiranë dhe në distancat deri në 100 km dhe 24 orë për spitalet më larg se 100 km.

Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe 5 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.

Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën, gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të përfshijë apo përjashtojë nga shërbimet e përmendura, pajisje të caktuara, veprim ndaj të cilit, i kontraktuari nuk ka të drejtë të kundërshtojë. Kjo mund të aplikohet në rastet e nxjerrjes jashtë përdorimit të pajisjeve apo shtimit të pajisjeve të reja për shkak të përfundimit të periudhës së garancisë.

Ky ndryshim do të rezultojë në rishikimin e kontratës. Vlera e zvogëluar ose shtuar do të llogaritet bazuar në vlerën ditore të mirëmbajtjes për atë pajisje dhe ditëve të përfshirjes në mirëmbajtje. Vlera ditore do të llogaritet bazuar në vlerën vjetore të mirëmbajtjes së asaj pajisjeje.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 7: “MIRËMBAJTE “FULL RISK” E PAJISJES MJEKËSORE ANGIOGRAFI SIEMENS/ ARTIS ZEE OSE EKUIVALENT”” PËR Q.S.R.T “SHEFQET NDROQI”.

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhues i	Modeli	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	Mirëmbajtje “Full Risk” e sistemit angiograf	Angiograf	Siemens / ekuivalent	Artis ZEE / ekuivalent	Q.S.R.T ”Shefqet Ndroqi”	48 muaj/ 1461 ditë

Shënim: *Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.*

Afatet e ekzekutimit: 48 (dyzetë e tetë) muaj ose 1461 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Loti 7: “Mirëmbajte “Full Risk” e pajisjes mjekësore Angiografi Siemens/ ARTIS ZEE” ose ekuivalent” për Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike.

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike.

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: “Q.S.R.T Shefqet Ndroqi”.

Shtojca 9.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

(E NJËJTË PËR LOTET 1, 2, 3, 4)

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10**;
- b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3**;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën (e vlefshme) **ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent** në përputhje me objektin e prokurimit e cila të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën (e vlefshme) **ISO 13485 për “Pajisjet mjekësore - Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente** në përputhje me objektin e prokurimit. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy) Inxhinier Biomedical/ Elektronik/ Mekatronik/ Informatik ose çdo arsim tjetër i ngjashëm/ Specialist në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet:

- Kopje e noterizuar e diplomës së Universitetit;
- Certifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,
- Kontrata e punes e vlefshme ose Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore të muajit të fundit
- CV.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Autorizim nga prodhuesi** / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë që merr përsipër furnizimi/zëvendësimin me pjesë këmbimi dhe aksesore sipas specifikimeve teknike:

- Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhues të tjerë të certifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.
- Të jenë të certifikuara me CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave të aprovuara në tregun Europian.
- Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesoret duhet të kenë manual instalimi shoqërues sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij manuali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.
- Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre.

Sqarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalojë afatin e kësaj kontrate. I kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë, pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjeçar të garancisë së pjesës së këmbimit.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku deklarohet se do të bëjë inspektimin e sigurisë së pasijseve mjekësore, të paktën 1(një) një inspektim sigurie sipas standartit ndërkombëtar elektrik IEC 62353 të specifikuar nga Direktiva e Pajisjeve Mjekësore MDD (ose MDR) 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, për çdo pajisje mjekësore dhe pjesëve përbërëse të saj gjatë

periudhës së kësaj kontrate, nëpërmjet stafit të trajnuar dhe certifikuar, kur kjo është e zbatueshme sipas specifikimeve teknike në Shtojcën 6 të DST.

Inspektimi përfshin:

- a. Operatori Ekonomik duhet të kryejë inspektim vizual, testime dhe matje me aparaturë të kalibruara.
- b. Operatori Ekonomik duhet të planifikojë kryerjen e këtyre testimeve në bashkëpunim me stafin e teknik bazuar në specifikimet e prodhuesit.
- c. Në përfundim të çdo inspektimi sigurie duhet të përpilohet një raport përshkruar dhe firmoset nga specialistët teknike dhe Inxhinieri/Tekniku i kompanisë (OE) që kryen testin.
- d. Pas çdo testimi sigurie në pajisje duhet vendosur një shenjë treguese e gjendjes së sigurisë së pajisjes.
